

POLITIKË, VIZION, MISION DHE STRATEGJI
PËR CILËSI, PËR MJEDIS JETËSOR DHE PËR SIGURI DHE SHËNDET GJATË PUNËS

Të gjithë ne në Agjencinë Informativë të Maqedonisë (MIA) Agjencinë tonë me funksion të **SERVISIT INFORMATIV PUBLIK**, e shohim si furnitorë të besueshëm të shërbimit **REGJISTRIM I PËRDITSHËM AGJIL TË NGJARJEVE DHE DUKURIVE NË VEND DHE NË BOTË DHE, PRODUKSION DHE EMITIM I VAZHDUSHËM I LAJMEVE DHE INFORMATAVE DHE MATERIALEVE TË TJERA PËRMES TEKSTIT, FOTOGRAFISË, AUDIO DHE VIDEO FORMATIT**, me qëllim të përmbushjes sa më cilësore kërkesave dhe të pritjeve të klientëve tanë.

MIA-n e çojmë dhe do ta çojmë gjithnjë drejt pozicioneve më të mira, por çdoherë në pajtim me përgjegjësinë shoqërore, me parandalim nga ndotja e mjedisit jetësor dhe me parandalim nga sëmundjet profesionale dhe lëndimeve gjatë punës.

Kjo politikë paraqet bazë për përcaktimin dhe për rishqyrtimin e vazhdueshëm të planeve, qëllimeve dhe nismave operative, në pajtim me kërkesat e standardeve:

ISO 9001:2008 Sistem për menaxhment me cilësi;

ISO 14001:2004 Sistem për menaxhment me mbrojtje të mjedisit jetësor dhe

OHSAS 18001:2007 Sistem për menaxhment me siguri dhe shëndet gjatë punës.

Politika u është kumtuar dhe sqaruar të gjitha palëve të interesuara me qëllim të kyçjes së tyre më aktive në raportin pozitiv ndaj mjedisit jetësor, si dhe për sigurinë dhe shëndetin e tyre gjatë punës, çdoherë kur aktivitetet i kryejmë së bashku.

Kjo Politikë na paraqet NEVE dhe si e tillë çdoherë është e kapshme për opinionin.

Ne veprimtarinë tonë e kryejmë në mënyrë të ndershme dhe të paanshme dhe, lidhur me këtë, do të përpiqemi në çdo moment të jemi të harmonizuar me kërkesat ligjore të Republikës së Maqedonisë, si dhe me të gjitha palët e interesuara me të cilat kemi vendosur dhe kemi ndërtuar marrëdhënie kontraktuese.

Në realizimin e aktiviteteve të veta të punës ne, në MIA insistojmë:

- vazhdimisht t'i avancojmë cilësinë dhe paanshmërinë e shërbimeve tona, lajmet dhe materialet e tjera informuese në pajtim me kërkesat dhe pritjet e shfrytëzuesve tanë;
- me qasje strategjike ta ulim ndikimin negativ ndaj mjedisit jetësor, në bashkëpunim me komunitetin shoqëror dhe publik, me qëllim të avancimit të mbrojtjes së mjedisit jetësor;
- rreziqeve dhe nga lëndimet dhe sëmundjet në punë, nga mobingu dhe ngjashëm, t'u qasemi në mënyrë primare me qëllim të eliminimit të tyre të tërësishëm, çdoherë kur kjo është e mundur apo uljen e tyre maksimale.

SISTEMET E MENAXHMENTIT DHE PARIMEVE TË TYRE I SHFRYTËZOJMË SI VEGLA PËR NGRITJEN E VETËDIJES DHE PËR KAHËZIMIN DHE UDHËHEQJEN E MIAS-S NË RRUGËN PA FUND, E KJO DO TË THOTË PËRMIRËSIM I VAZHDUESHËM I SISTEMEVE, TË TË GJITHA AKTIVITETEVE TONA AFARISTE, SI DHE TË GJITHË NEVE SI INDIVIDË.

Shkup, 26 dhjetor 2011



Lupço Jakimoski,
drejtor i përgjithshëm